

Analizë e politikave

# Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë



# Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë

Të drejtat e autorit © 2026. **Demokrasi për Zhvillim (D4D)**.

*Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përveç citimeve të shkurtra për qëllime të kritikës dhe të shqyrtimit, asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikuperimit të të dhënave ose të transmetohet në asnjë formë ose me asnjë mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër pa lejen paraprake të D4D.*

Ky dokument është realizuar me mbështetjen e projektit "Mbështetje për shoqërinë civile në Kosovë", financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe implementuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Demokrasi për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.



## Tabela e përmbajtjes

|  |           |
|--|-----------|
| <b>Përmbledhje.....</b>  | <b>4</b>  |
| <b>Hyrje .....</b>   | <b>6</b>  |
| <i>Diskutimet dhe pyetjet .....</i>  | <i>8</i>  |
| <b>Diagnoza e përgjithshme e problemit<br/>.....</b>   | <b>10</b> |
| <b>Përvojat në Kosovë deri tani dhe<br/>sfidat për institucionalizim dhe<br/>masovizim .....</b> | <b>14</b> |
| <b>Nga standardet evropiane te<br/>praktikat e shteteve baltike .....</b>                        | <b>16</b> |
| <b>Objektivi kryesor .....</b>   | <b>17</b> |
| <b>Institucionalizim të edukimit medial<br/>dhe mendimit kritik .....</b>                        | <b>18</b> |



## Përmbledhje

Kosova po përballet me një çrregullim informativ ku dezinformimi po kthehet në një problem strukturor që cenon mirëqenien shoqërore dhe institucionet demokratike. Tekstet aktuale shkollore janë të vjetruara dhe nuk adresojnë rreziqet moderne si inteligjenca artificiale (deepfakes), algoritmet e rrjeteve sociale apo censurën e turmave. Për më tepër, ekziston një hendek i madh mes aftësive teknike të nxënësve dhe kapaciteteve pedagogjike të mësimit të mësimdhënësve për të trajtuar këto tema në mënyrë kritike.

Për të trajtuar këtë, ky dokument propozon kalimin nga metodat pasive të mësimit drejt vaksinimit psikologjik. Duke u bazuar në praktikën e vendeve baltike, qëllimi është që nxënësit të mos mësojnë vetëm si të korrigjojnë një lajm të rremë, por të identifikojnë teknikat e manipulimit përpara se të ekspozohen ndaj tyre. Platforma **verifiko** e zhvilluar nga Instituti D4D mund të shërbejë si mjet praktik për të integruar këtë edukim përmes lojërave, debateve dhe rasteve reale që mund të shfrytëzohet nga nxënësit, prindërit dhe arsimtarët.

Për të arritur një ndikim të qëndrueshëm, propozohet një qasje e koordinuar në tre shtylla:

**Institucionalizimi i planprogramit:** Edukimi medial nuk duhet të mbetet fragmentar, por të integrohet si lëndë obligative në klasat 9-12 të shkollave të mesme, si dhe të trajtohet si kompetencë ndërkurrikulare në lëndët si gjuhë shqipe, histori dhe TIK.

**Ngritja e kapaciteteve:** Kalimi i mësimit nga roli i ligjëruesit në atë të lehtësuesit (facilitator) përmes trajnimeve intensive mbi etikën digjitale dhe AI, duke caktuar një mësues përgjegjës (Lead) për edukim medial në çdo shkollë.

## Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë



**Përfshirja e ekosistemit:** Krijimi i një ure bashkëpunimi mes institucioneve, shkollës, prindërve dhe shoqërisë civile, që përfshin krijimin e moduleve specifike për prindërit në platformën *shkollat.org* dhe mbështetjen e klubeve shkollore për verifikim të fakteve.

Deri në vitin 2026, Kosova duhet të synojë harmonizimin e sistemit të saj arsimor me Standardet Evropiane të Qytetarisë Digjitale. Qëllimi përfundimtar është krijimi i një gjenerate të mbrojtur nga manipulimi, e cila kontribuon aktivisht në një hapësirë publike të shëndetshme dhe transparente. **Objektivat kryesore:**

- **Institucionalizimi:** Integrimi i edukimit medial si lëndë obligative (klasët 9-12) dhe kompetencë ndërkurrikulare.
- **Ngritja e Kapaciteteve:** Transformimi i mësimdhënësve në lehtësues të procesit përmes trajnimeve mbi etikën digjitale dhe AI.
- **Bashkëpunimi:** Përfshirja e prindërve dhe shoqërisë civile përmes platformës *shkollat.org*, *verifiko.info* dhe klubeve të verifikimit të fakteve



## Hyrje

Ky dokument është hartuar si pjesë e nismës që zbaton D4D me **qëllim për të rritur vetëdijen për përmasat e rrezikut dhe për të rritur njohuritë si identifikohet dhe luftohet dezinformimi përmes mendimit kritik, edukimit për demokracinë dhe mediat**. Objektivi i përgjithshëm i kësaj nisme është rritja e transparencës mediatike dhe e të menduarit kritik në përgjithësi dhe për njohuritë mediale në veçanti. Plani për të arritur këtë është përmes edukimit të të rinjve me përfshirje të familjeve, profesionistët e shkollave dhe publikun e gjerë mbi konsumin e përgjegjshëm të përmbajtjes dixhitale; duke futur standardet evropiane të verifikimit të fakteve. D4D ka zbatuar projekte të ndryshme në të kaluarën për edukimin medial, mendimin kritik, edukimin për demokracinë ([NDEAP](#)).

Kostoja e vërtetë e dezinformimit nuk matet vetëm me lajme të rreme, por me dëme reale dhe afatgjata për shoqërinë. Ajo buron nga disa kategori kryesore:

- ⇒ përparimet digjitale, ku deepfake-et dhe manipulimet vizuale mund të shkatërrojnë reputacione, të ndikojnë zgjedhje ose të nxisin dhunë;
- ⇒ keqpërdorimi i besimeve fetare, kur narrativa të rreme paraqiten si të shenjta për të justifikuar urrejtjen, përjashtimin ose konfliktin; dhe
- ⇒ sulmet sistematike ndaj shkencës, që kanë çuar në mosbesim masiv ndaj vaksinave, me kosto miliona jetë të rrezikuara dhe sisteme shëndetësore të mbingarkuara.

Në të gjitha rastet, dezinformimi gërryen besimin publik, dobëson institucionet dhe e bën shoqërinë më të cenueshme ndaj krizave politike, shëndetësore dhe të sigurisë.

D4D ka zhvilluar platformën [Verifiko](#) si një mjet praktik dhe gratis për t'i ndihmuar të rinjtë, mësuesit dhe prindërit të dallojnë

## **Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë**



informacionin e besueshëm nga ai i rremë, dhe për të mësuar më tepër për mendimin kritik dhe dezinformimin. Platforma përmban module të dizajnuara për t'u përdorur në klasë dhe në aktivitete jashtëshkollore. Është menduar që platforma të shërbejë si vegël interaktive e cila vazhdimisht popullohet me përmbajtje të re, ku raportohen raste të dezinformimit nga studentët dhe e cila mirëmbahet bashkërisht me shkollat, prindërit dhe nxënësit. D4D ka punuar edhe me mësues duke u prezantuar platformën dhe u qëndron në dispozicion. Qëllimi është që platforma të jetë e hapur në dispozicion të gjërë ku mësues, nxënës, prindër të mund jo vetëm t'a shfrytëzojnë por edhe t'a popullojnë atë me shembuj, të raportojnë raste të manipulimit përmes kësaj, të gjithat nën mbikqyrje profesionale.

Për të adresuar në mënyrë efektive sfidën e dezinformimit, D4D synon të sjellë bashkë një ekosistem të gjerë aktorësh që duhet të veprojnë në mënyrë të koordinuar. Në qendër qëndrojnë institucionet publike të arsimit dhe politikëbërjes, përfshirë MASHT-in, DKA-të dhe Institutin Pedagogjik të Kosovës (IPK), i cili përmes sektorëve të kërkimit, arsimit të përgjithshëm, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe vlerësimit/standardeve kontribuon në modernizimin e sistemit arsimor. Këtyre u bashkohen shkollat si hapësira kyçe zbatimi (përmes klubeve mediale dhe këshillave të prindërve), vetë prindërit si aktorë edukimi jashtëshkollor, botuesit e teksteve mësimore, OJQ-të e specializuara në edukim medial dhe mendim kritik, si dhe Departamenti i Gazetarisë dhe mediat profesionale që luajnë rol në ekspozimin dhe demaskimin e lajmeve të rreme. Vetëm përmes bashkëpunimit të këtyre aktorëve – nga politika dhe arsimit te media dhe shoqëria civile – mund të ndërtohet një qasje e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse kundër dezinformimit.



## Diskutimet dhe pyetjet

Para hartimit të këtij dokumenti, D4D ka takuar grupe të ndryshme interesi, opinionet e të cilëve janë shkruar këtu. Në këto diskutime të lira por të strukturuar dhe të moderuara, pjesëmarrës të ndryshëm (studentë, ekspertë, mësues, prindër) kanë propozuar ide të ndryshme dhe konkrete, të cilat paraqiten këtu. Qëllimi ishte të gjenerojmë ide konkrete dhe të zbatueshme për hapat e mëtejshëm, si të përdoret një platformë e tillë për mësimnxënie, si t'i lidhim ato me programet ekzistuese mësimore dhe si t'i mbështesim mësuesit për të integruar këto përmbajtje në mënyrë të qëndrueshme. Deri tani, tema të tilla pak mësohen në shkollat dhe kryesisht mbështetemi tek donatorët për diç të tillë, por qëllimi është institucionalizimi i kësaj teme të rëndësishme si pjesë të planprogramit bazë. Disa nga pyetjet që kemi parashtruar për të nxitur diskutim janë të listuara më poshtë:

**Gjendja aktuale:** Si trajtohet aktualisht (nëse trajtohet) temë e dezinformimit dhe mendimit kritik në shkollat e mesme që ju njihni? (shembuj konkretë). Cilat janë pengesat më të mëdha që kanë mësuesit për t'u marrë me këtë temë? (koha, trajnimi, materiali, mbështetja institucionale)

**Përdorimi i Verifiko si mjet mësimor.** Cilat module të Verifiko (p.sh. "Llojet e dezinformimit", "Siguria online") duken më të përshtatshme për nxënësit e klasave të larta? Si mund t'i përshtatim aktivitetet për 10–12 klasë? Si mund t'i kthejmë modulet në mësim 45–90 min që mësuesit t'i përdorin brenda lëndëve ekzistuese?

**Integrimi kurrikular dhe institucional.** Në cilat lëndë të arsimit të mesëm do të ishte më natyrale të integrohej përmbajtja (p.sh. Civics/Citizenship, Informatikë/ICT, Gjuha dhe Letërsia, Historia, Mediat/Komunikimi)? Çfarë formati integrimi preferohet: si modul i veçantë, si teme cross-curriculare, apo si aktivitet jashtëkurrikular?

## Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë



Çfarë roli mund ta luajë Ministria e Arsimit dhe Qendrat Pedagogjike për përfshirje dhe për shpërndarje të qëndrueshme?

**Metodat mësimore dhe angazhimi i nxënësve.** Cilët lloj aktiviteteve praktikë (debate, fact-checking praktike, projekte multimedia, gazeta shkollore, “check-and-report” me Verifiko) do të ishin më tërheqëse për nxënësit? Si mund të përfshihen nxënësit në krijimin e përmbajtjes (p.sh. raporte shkollore të rreme që nxënësit verifikojnë dhe publikojnë rezultatet)?

**Qëndrueshmëria dhe matja e ndikimit.** Si masim suksesin e një pilot-projekti? (p.sh. para/mbas teste për mendimin kritik, analiza cilësore nga mësuesit, numri i rasteve të raportuara/konfirmuara në Verifiko). Cilat hapa konkretë duhet të ndërmerren brenda 3, 6 dhe 12 muajve për të nisur dhe për të zgjeruar iniciativën?



# Diagnoza e përgjithshme e problemit

Dezinformimi në Kosovë nuk ka të bëjë me teknologjinë dhe gjeneratat e vjetra mund të kujtojnë se propaganda është përdorur edhe kur ka pasur fare pak teknologji. Një kombinim i mungesës së mendimit kritik dhe zhvillimit të shpejtë të AI tejkalon kapacitetet institucionale dhe shoqërore për të ballafaquar me të me disa probleme të theksuara si:

Në Kosovë, dezinformimi dhe mungesa e mendimit kritik po shndërrohen në një problem strukturor arsimor dhe shoqëror. Edukimi medial dhe mendimi kritik preken vetëm në mënyrë fragmentare në shkolla, kryesisht përmes lëndëve ekzistuese dhe projekteve të mbështetura nga donatorët. Që nga viti 2023, edukimi medial ekziston si lëndë zgjedhore, por pa mbështetje të mjaftueshme me materiale cilësore dhe pa mbështetje sistematike për mësime të mësimdhënësit. Më poshtë kemi ndarë diagnozën në disa lloje sipas të gjeturave:

**1. Dezinformimi politik dhe propaganda klasike.** Këtu hyn narrativa propagandistike tradicionale dhe politike (p.sh. trashëgimia e propagandës shtetërore dhe polarizimi politik). Sidomos te gjeneratat më të vjetra, është i përhapur pranimi i pakushtëzuar i informacionit që përputhet me bindjet ekzistuese. Komentet në rrjete sociale trajtohen si fakte, pa verifikim apo kontekst. Një pjesë e gazetarëve kufizohen nga vetë-censura për shkak të presionit politik, sulmeve të organizuara online apo reagimit të pritur të turmës. Polarizimi shoqëror (politik, mes gjeneratave, etj), ka ndikuar në mungesë të qasjes kritike.

**2. Dezinformimi digjital dhe inteligjenca artificiale.** Telefonat e mençur përdoren skajshëm, kryesisht për media sociale, ku fëmijët ekspozohen pa filter, pa mbrojtje të të dhënave. Manipulime



vizuale dhe përmbajtje të gjeneruara nga AI (përfshirë falsifikatet e thella) që e bëjnë gjithnjë e më të vështirë dallimin mes faktit dhe trillimit. Përdorimi i AI nga nxënësit për detyra shkollore bëhet pa kuptuar funksionimin, kufizimet dhe rregullat etike (p.sh. detyra identike të gjeneruara nga ChatGPT). Në përgjithësi, ka mungesë totale të udhëzimeve për përdorim etik të AI, si për nxënësit ashtu edhe për mësimmshënësit.

**3. Mungesa e mendimit kritik në media.** Ka narrativa kundër vaksinimit dhe shkencës, të ushqyera nga rrjetet sociale dhe figurat me autoritet. Mungesa e aftësisë për të dalluar faktin shkencor nga opinioni personal, që mund t'i prek edhe mësimmshënësit, ka kosto të lartë shoqërore dhe miliona njerëz të pavaksinuar globalisht, mbingarkesë e sistemeve shëndetësore dhe humbje jete. Shumë mësimmshënës ende nuk dinë të bëjnë dallimin mes faktit dhe opinionit, çka e bën edhe më të domosdoshëm futjen e kësaj fushe në sistemin arsimor. Komponenta digjitale e kurrikulës aktualisht ka shumë pak aktivitete që lidhen me edukimin medial. Edhe në tekstet shkollore, temat për mediat prezantohen vetëm në mënyrë të përgjithshme dhe jo në formë të detajuar apo praktike. Mungesa e mendimit individual gjithashtu krijon hapësirë për censurë të turmave ku individët frikësohen të shprehin mendimin nga frika e gjykimit kolektiv.

**4. Gjendja aktuale e teksteve shkollore,** veçanërisht në lëndën e Edukatës Qytetare, paraqet një sfidë serioze për shkak të materialeve të vjetruara që nuk përkojnë me ritmin e zhvillimit të teknologjisë dhe mediave sociale. Kapitujt mbi mediat në nivele të ndryshme shkollore shpesh janë hartuar nga autorë që nuk janë njohës të mirëfilltë të studimeve mediatike, duke rezultuar në përmbajtje që nuk janë aktuale. Ky problem nuk është i izoluar vetëm në Kosovë, por ka përmasa globale; madje edhe dy tekstet kryesore të edukimit medial në botë dështojnë të shpjegojnë nivelin aktual teknologjik, me botimet e tyre të fundit në vitet 2021



dhe 2023. Edhe botimet specifike si ato nga "Albas" nuk arrijnë të prekin tematikat esenciale, siç është fakti që rreth 50% e përmbajtjes mediatike sot vjen nga fusha e PR-it. Edhe pse disa lëndë i prekin elementet e edukimit medial, ato nuk e trajtojnë thelbin, sepse nuk shpjegojnë në mënyrë të qartë si verifikohet një lajm apo si analizohet informacioni në mënyrë kritike. Për më tepër, këto tekste injorojnë platformat me ndikim masiv si TikTok-u dhe dështojnë të adresojnë banalitetin e përmbajtjes që qarkullon në to, duke e lënë nxënësin të papërgatitur për realitetin digjital.

#### **5. Keqpërdorimi i besimeve fetare dhe narrativave identitare.**

Përdorimi i besimeve fetare nganjëherë përdoren për të legjitimuar narrativa të rreme, përjashtuese ose polarizuese. Kjo reduktim mendimin kritik për shkak të autoritetit moral që u atribuohet këtyre narrativave. Gjithashtu, në shoqëri si tonat akoma janë të përhapura shumë shprehi të vjetra që konsiderohen si njohuri por nuk kanë asnjë bazë empirike. Shumë individë më pas përhapin informata të paverifikuara duke thënë: më tha dikush apo e pashë dikund – dtth informata e paverifikuar përhapet me shpejtësi.

#### **6. Hendeku pedagogjik dhe mungesa e edukimit medial në arsim.**

Një çështje tjetër thelbësore e ngritur është keqkuptimi i edukimit medial, i cili shpesh reduktohet gabimisht vetëm në sferën e medias dhe gazetarisë. Në të vërtetë, edukimi medial përfshin një spektër shumë më të gjerë, si identifikimin e dezinformatave, vlerësimin e rreziqeve kibernetike dhe njohjen e platformave të sigurta. Një pengesë kryesore në këtë drejtim mbeten vetë mësimmshënësit; mungesa e njohurive të tyre mbi rëndësinë dhe përmbajtjen e kësaj fushe konsiderohet një mangësi serioze në sistemin arsimor. Fakti që shumë edukatorë ende e kanë të vështirë të bëjnë dallimin mes faktit dhe opinionit tregon se orët e mësimit shpesh realizohen vetëm formalisht, pa prekur thelbin e problemit. Shumë mësimmshënës nuk dinë të dallojnë faktin nga opinionin dhe nuk e kuptojnë plotësisht konceptin e edukimit

## Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë



medial. Orët mësimore shpesh plotësohen formalisht, pa fokus në thelb. Pra ekziston një mospërputhje e madhe mes aftësive teknike të nxënësve ("digital natives") dhe metodave klasike të mësimdhënësve.

**7. Kriza e leximit dhe përqendrimi i shkurtër.** Fëmijët lexojnë shumë më pak dhe kanë probleme serioze me kuptimin e tekstit (reading comprehension). Dominimi i videove të shkurtra (30 sekonda – 3 minuta) ka reduktuar aftësinë për fokus dhe analizë. Truri është pasiv gjatë konsumimit të videove, ndërsa leximi aktivizon mendimin kritik. Varësia nga scroll-i dhe logjika e marketingut digjital e kanë fragmentuar vëmendjen edhe te gjeneratat më të vjetra. Prindërit nuk janë të pajisur me njohuri bazike për AI dhe platformat digjitale, edhe pse ndikimi i tyre në edukimin e fëmijëve është i madh.



## Përvojat në Kosovë deri tani dhe sfidat për institucionalizim dhe masovizim

Në Kosovë ka disa **model të mirë dhe nisma të dukshme që po kontribuojnë në luftën kundër dezinformimit** dhe në forcimin e edukimit medial për publikun e gjerë. **Krypometri** është platformë e pavarur e kontrollit të fakteve brenda **Kallxo.com** e cila tregon pse përmbajtje të caktuara në Facebook janë dezinformata apo i mungon konteksti, duke ndihmuar përdoruesit të kuptojnë arsyet prapa etiketimit. **Hibrid.info** është platformë që punon sistematikisht në verifikimin e fakteve, analizë kritike të përmbajtjeve, raporte mbi keqinformimin, trajnime për edukim medial/digjital dhe ngritje kapacitetesh për gazetarë dhe qytetarë, për të zvogëluar ndikimin e përmbajtjeve mashtruese në publik. Përveç këtyre aktorëve, edhe **Misioni i OSBE-së/OSCE-së në Kosovë** ka publikuar raporte dhe **materiale udhëzuese mbi edukimin medial dhe informativ**, si pjesë të përpjekjeve për të forcuar qëndrueshmërinë e medias dhe aftësitë e analizës kritike në shoqëri. Më herët kishte aktivitete si **Kosovision** (e zbatuar nga KEC), që inkurajonte vlerat demokratike përmes aktiviteteve për klasat e 5-ta. Këto iniciativa bashkëpunojnë drejtpërdrejt ose indirekt me shkolla, organizata qytetare dhe media për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, fuqizuar qytetarët me mjete për të dalluar informacionin e besueshëm nga ai manipulues dhe për të ngritur kapacitetet analitike ndaj dezinformatave. **Platforma e edukimit medial e Democracy Plus (D+)** ofron kurse interaktive dhe një **indeks të cënueshmërisë ndaj dezinformimit** që analizon pikat më të prekshme në shoqëri ndaj lajmeve të rreme. Projekti **“Media Smart – Youth Vlog Against False Information”**, i implementuar nga **The Balkan Forum dhe partnerë të tjerë**, ka

## Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë



trajnuar të rinj për të prodhuar përmbajtje kreative që lufton dezinformimin dhe nxit mendimin kritik te publiku i gjerë.

Këto shembuj tregojnë se ka **intervenime konkrete** në terren — nga trajnime praktike, platforma digjitale, kurse dhe projekte multimediale — **por gjithashtu shpalosin sfidat ekzistuese** si mos-integrimi i qëndrueshëm në kurrikula, mungesa e materialeve lokale praktikë dhe mbështetja e pabarabartë për grupet e ndryshme të nxënësve.

Korniza Kurrikulare e Kosovës ofron hapësirë që zhvillimin e kompetencave të të nxënësve të përfshihet zyrtarisht, përfshirë kompetencat digjitale dhe edukimin medial, dhe disa ndërhyrje kanë nisur tashmë në këtë drejtim. Edukatorët qytetarë përmban një kapitull relativisht cilësor për edukimin medial, ndërsa në arsimin e hershëm janë pilotuar qasje praktike të digjitalizimit që nxisin mendimin kritik përmes përdorimit të mjeteve digjitale në klasë dhe jashtë saj. Ka lëndë zgjedhore për edukim medial, janë zhvilluar disa trajnime për mësimdhënës dhe edukatorë, janë përgatitur udhëzues praktikë dhe Ministria e Arsimit ka shprehur vullnet për të avancuar më tej integrimin e teknologjisë, në përputhje me praktika të mira ndërkombëtare.

Këto përpjekje kanë mbetur të kufizuara në ndikim për disa arsye strukturore: trajnimet e mësimdhënësve nuk janë të qëndrueshme dhe shpesh nuk shkojnë përtej kërkesave formale për licencim. Tekstet dhe materialet ose mungojnë ose nuk janë mjaft atraktive dhe të azhuruara. Kapacitetet e mësimdhënësve dhe nxënësve për të identifikuar dezinformimin, veçanërisht përmbajtjet e gjeneruara nga AI, mbeten të dobëta. Problemet thellohen edhe nga mungesa e përfshirjes së prindërve, paqartësitë rreth rolit të edukatorëve dhe vështirësitë për ta integruar edukimin medial si kompetencë ndërkurrikulare, sidomos në arsimin parauniversitar.



Si përmbledhje, sfida kryesore është mungesa e një qasje më institucionale dhe afatgjate me ndikim të ndjeshëm brenda sistemit formal shkollor. Edhe pse baza formale ekziston, mungesa e planifikimit të qartë, materialeve praktike dhe mbështetjes sistematike shpjegon pse ndërhyrjet deri tani nuk kanë prodhuar efektin e dëshiruar.

## Nga standardet evropiane te praktikat e shteteve baltike

Sipas standardeve të Bashkimit Evropian, mbi 80% e vendeve të punës në të ardhmen do të kërkojnë kompetenca digjitale të avancuara. Në këtë kontekst, edukimi medial nuk mund të mbetet një lëndë opsionale. Këto njohuri tani janë në mesin e shkathtësive të domosdoshme për tregun e punës së të ardhmes si dhe për sigurinë kombëtare dhe qëndrueshmërinë shoqërore. Shtetet Baltike (Estonia, Latvia dhe Lituania) shërbejnë si referencë globale në këtë fushë, për shkak të përvojës së tyre të gjatë në përballjen me dezinformimin sistematik nga jashtë.

**Estonia:** Ka integruar shkrim-leximin digjital si kompetencë mandatore, duke u renditur si vendi më rezistent ndaj dezinformimit në Evropë. Që nga viti 2024, kjo fushë është një nga tetë kompetencat kombëtare të detyrueshme. **Lituania:** Ka adoptuar qasjen "Mbarëshoqërore" (Whole-of-Society), duke krijuar një komunitet "StratCom" ku OJQ-të, gazetarët dhe edukatorët bashkëpunojnë për prodhimin e materialeve mësimore në kohë reale. **Latvia:** Është fokusuar në përfshirjen e pakicave (si rinia rusofone) përmes laboratorëve të aftësive (*Skills Labs*) për të garantuar kohezionin social. **Finlanda** e ka edukimin medial pjesë sistematike të kurrikulës, ndërsa **Norvegjia**, përmes programeve të Qendrës Evropiane "Wergeland" (EWC), promovon qytetarinë digjitale si shtyllë të demokracisë.



Gjatë zbatimit në këto vende, ata kanë nxjerrë mësim të shumta nga sfidat që kanë pasur. Mësimdhënësit shpesh e shohin edukimin medial si një "barrë shtesë" dhe jo si një kërkesë thelbësore. Përmbajtjet e gjeneruara nga Inteligjenca Artificiale (si *deepfakes*) zhvillohen më shpejt se sa mund të botohen tekstet shkollore, që e bën të domosdoshëm mësimin me vegla interaktive online që mund të pasurohen vazhdimisht.

## **Objektivi kryesor**

Problemi i dezinformimit në Kosovë nuk është thjesht çështje teknologjike apo përmbajtjeje, por kombinim i (a) mungesës së mendimit kritik, (b) edukimit medial të pamjaftueshëm, (c) krizës së leximit dhe përqendrimit, (d) polarizimit politik dhe identitar, dhe (e) zhvillimit të shpejtë teknologjik që tejkalon kapacitetet institucionale. Kjo diagnozë tregon nevojën që edukimi medial dhe mendimi kritik të trajtohen si kompetenca bazë jetësore, të integruara në mënyrë të qëndrueshme në sistemin arsimor, fillimisht si lëndë zgjedhore e përforcuar, e më pas si lëndë obligative.

Duhet nxjerrë leksionet e sfidave dhe arritjeve të vendeve të tjera dhe të bazojmë planet tona, duke përfshirë edhe **Inteligjencën Artificiale** dhe standardet e **Konventës 108+ të Këshillit të Evropës**. Mësimdhënësi duhet të kalojë nga roli i autoritetit absolut në atë të lehtësuesit, duke nxitur debatin dhe mendimin kritik. Qëllimi është që nxënësit të aftësohen për të dalluar faktin nga opinioni, për të kuptuar pasojat e përdorimit të rrjeteve sociale dhe për të naviguar sigurt në televizion, radio dhe internet. Për këtë qëllim, nevojiten platforma ndërvepruese që përfshijnë nxënësit, prindërit dhe edukatorët në një proces të përbashkët mësimnxënies.



# Institucionalizim të edukimit medial dhe mendimit kritik

Mendimi kritik dhe edukimi medial duhet të integrohen intensivisht në të gjithë ciklin arsimor, që nga niveli parashkollor deri në atë universitar. Përtej aspekteve teknike, fokusimi duhet të jetë tek vaksinimi psikologjik digjital - në vend që të korigjojme gënjeshtëri pasi është përhapur (*debunking*), nxënësit duhet të pajisen me mjetet e nevojshme për të identifikuar paraprakisht (*prebunking*) teknikat e manipulimit emocional dhe dilemat e rreme. Për të qenë efektivë me "gjeneratën e TikTok-ut", duhet të flasim me të njëjtën frekuencë, duke përdorur qasje që i tërheqin ata, ndërsa përfshijmë prindërit në njohjen e rreziqeve dhe mundësive të Inteligjencës Artificiale (AI).

**1. Rishikimi i teksteve shkollore.** Si hapi parë, propozohet udhëheqja e një procesi të përbashkët për hartimin e trajnimeve të dedikuara për mendimin kritik brenda shkrim-leximit. Është e domosdoshme të kryhet një hulumtim i qartë për të analizuar se si po zbatohet edukimi medial aktualisht, qoftë si lëndë zgjedhore apo ndërdisiplinore duke vlerësuar krahas Kornizës referencë të Këshillit të Evropës për kompetencat për kulturë demokratike. Procesi aktual i rishikimit të teksteve shkollore paraqet një mundësi për të vlerësuar dhe integruar përmbajtjen mediale në lëndët përkatëse, duke siguruar që materialet të mos mbeten vetëm teorike, por të zbatohen praktikisht nga mësimdhënësit. Konsultimet pastaj mund të zhvillohen mes qendrave pedagogjike, dhe MASHT për integrim të zgjidhjes si aktivitet pilot që mund të përhapet në fazë të mëvonshme.

**2. Integrimi kurrikular dhe lënda obligative.** Qëllimi është që edukimi medial të mos mbetet një aktivitet i izoluar, por një tipar që përshkon të gjithë sistemin. Një model është ai **hibrid**: Integrimi

## Fuqizimi i qëndrueshmërisë ndaj dezinformimit përmes mendimit kritik dhe edukimit mbi demokracinë në Kosovë



i mendimit kritik në lëndët ekzistuese (p.sh., analiza e *clickbait* në Gjuhë dhe Letërsi, verifikimi i burimeve në Histori, dhe siguria online në TIK). Modeli tjetër më efikas është **lënda e Veçantë Obligative**: Nga klasa e 9-të deri në të 12-tën, kjo lëndë do të mundësonte trajtimin e thelluar të temave që nuk mbulohen dot diku tjetër. Lënia e kësaj fushe në dorë të vullnetit individual (si lëndë zgjedhore) nuk garanton mbrojtjen e nevojshme për nxënësit në epokën digjitale. Mund të pilotohen disa modele në shkolla të ndryshme duke shfrytëzuar module të gatshme nga Verifiko. Gjithashtu mund të lansohet një pilot sipas modelit baltik "Mediathon".

**3. Infrastruktura digjitale dhe materialet interaktive.** Duke njohur realitetin e Kosovës, ku qasja në teknologji ndryshon mes zonave urbane dhe rurale, nevojitet një kombinim mes librit fizik dhe moduleve online. Ndoshta mund synohet që kjo të jetë lënda e parë pa libër, por që mësohet me nje app që mund të punojë edhe off-line (pa internet) dhe për shfrytëzimin e të cilës mjafton një telefon më bazik. Ky app, apo version në web, do të mund të shfrytëzonte modulet e "Verifiko" e cila mund të integrohet edhe në shkollat.org. Verifiko tutje mund të udhëzojë arsimtarët tek resurse tjera shtesë, qoftë lojëra, libra në audio, si dhe resurse mësimore.

**4. Ngritja e Kapaciteteve: Trajnimi i Mësimdhënësve.** Mësimdhënësi duhet të transformohet nga një ligjërues klasik në një lehtësues (*facilitator*) që kërkon më tepër shkathtësi metodologjike sesa të bëhet ekspert për temën. Kjo kërkon **trajnime të arsimtarëve** mbi algoritmet, etikën mediatike dhe AI. Në pamundësi për të trajnuar numër të madh, mund të caktohet një mësuesi përgjegjës në çdo shkollë si pikë referimi. Trajnimi i mësuesve për të integruar teknika që nxisin nxënësit të zgjidhin raste reale të dezinformimit mbyll hendekun mes aftësive teknike të nxënësve dhe njohurive pedagogjike të mësuesve.



### **5. Ekosistemi mbështetës nga shkolla, prindërit dhe komuniteti.**

Edukimi medial duhet të shtrihet edhe jashtë bankave të shkollës përmes një ekosistemi gjithëpërfshirës që përfshin **klubet** (p.sh. klubeve të debatit dhe për verifikim të fakteve që mund të bëhen në mënyrë vullnetare dhe me mbështetje shtesë nga grantet), **edukimi i prindërve**: Krijimi i hapësirave informuese mbi rreziqet në TikTok dhe sigurinë e familjes online, dhe **pjesëmarrja qytetare** (përdorimi i platformave digjitale për votime në shkollë apo parlamente të nxënësve, duke ilustruar se si informata e saktë ndikon drejtpërdrejt në vendimmarrjen kolektive.

Përfundimisht, të gjitha projektet pilot duhet të vlerësohen për të vendosur me informata të plota se cilat përvoja duhet institucionalizuar si pjesë të planprogramit të përhershëm dhe cili është mekanizmi që ato do t'i azhurojë në mënyrë të vazhdueshme që të jenë në hap me kohën. Pas fazës pilot, mund të kërkohet me kurikulë që të mandatoen 10% të orëve të shkencave sociale për "Laboratorët e Demokracisë Digjitale" deri në vitin 2027.





[www.d4d-ks.org](http://www.d4d-ks.org)

Democracy for Development  
Demokraci për zhvillim  
Demokratija za razvoj

